



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.971 /20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Drita Rexhaj dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.D., nga Kaçaniku të cilën e përfaqëson me autorizim av. N.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) sh.a, me seli në Prishtinë bulevardi "Bill Kllinton", nr.3, të cilën e përfaqëson me autorizim Ardian Jashari, me objekt të padisë kthimin në vendin e punës dhe kompensim i pagave, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.91/17, të datës 01.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më **06.05.2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit J.D. nga Kaçaniku, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj–Dega në Kaçanik C.nr.91/17, i datës 01.11.2019, **VERTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar C.nr.97/17, të datës 01.11.2019, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit J.D. nga Kaçaniku, e ushtruar ndaj të paditurës KEDS, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kthimin në vendin e punës dhe pagesën e pagave nga data 07.05.2017, e deri në marrjen e aktgjykimit. Në pikën II të dispozitivit gjykata ka detyruar palën paditëse që në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi të paguaj shumën prej 100 euro në emër të shpenzimeve procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të vlerësimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës që aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik me nr. C.nr.91/17 të

datës 01.11.2019, ta anuloi në tërësi ashtu që ankesën e përfaqësuesit të paditësit ta miratojë të bazuar, dhe ta kthejë çështjen në rivendosje në Gjykatën Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik.

Pala e paditur nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me padinë e parashtruar ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës në pozitën operator i nënstacionit dhe t'ia paguaj pagat me kamatë prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Gjithashtu të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore.

Duke vendosur rreth kërkesëpadisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave si në vijim: kontrata e punës me nr.12265/4584, e datës 01.10.2014, njoftimi i të paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës i datës 05.04.2017 nr.22, kontratën e punës nr.12265/8835, të datës 08.05.2016, vendimi i shkallës së dytë me nr.4086, i datës 25.04.2017, si dhe ekspertiza e ekspertit financiar R.F. i datës 30.08.2019, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar gjykata ka theksuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune të e paditura nga viti 2014 dhe së fundmi sipas kontratës së punës nr.12265/8835, të datës 08.05.2016, e lidhur për afat të caktuar kohor, i caktuar në punët dhe detyrat e punës si operator i nënstacionit, në kohëzgjatje prej datës 08.05.2016-07.05.2017. Meqenëse është konstatuar se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë pune në kohë të caktuar, ku janë pajtuar për të gjitha pikat e kontratës së punës, përfshirë këtu edhe kohëzgjatjen e saj, është ardhur në përfundim se nuk ka ekzistuar vullneti i të paditurës për të vazhduar më tej marrëdhënien e punës me paditësin. Në anën tjetër, ka konstatuar se e paditura ka respektuar në tërësi procedurën e paraparë me Ligjin e Punës, përkatësisht nenin 67, pika 1.3, lidhur me nenin 71 parag. 2, pasi që e ka informuar të punësuarin 30 para skadimit të kontratës për qëllimin e mos vazhdimin të kontratës së punës, si dhe i ka kompensuar të gjitha të ardhurat personale deri në përfundimin e kontratës së punës. Gjithashtu ka konstatuar se meqenëse paditësi me të paditurën ka themeluar marrëdhënien e punës në vitin 2014, ndërsa kontrata e fundit ka pasur kohëzgjatje deri me datë 07.05.2017, atëherë edhe nuk plotësohen kushtet ligjore për zbatimin e dispozitës së nenin 10 parag. 3 të Ligjit të Punës, për ta konsideruar kontratë pune në kohë të pacaktuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ankuese për shkeljet që i referohen shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën, ashtu siç e përcakton parag. 3 i nenit 160 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se marrëdhënia e punës në mes paditësit dhe të paditurës ka qenë e lidhur konform nenit 10 para 2.2 të Ligjit të Punës 03/L-212, i datës 01.11.2010, ku shprehimisht përcaktohet se: *"Kontrata e Punës mund të lidhet për: një periudhë të pacaktuar; një periudhë të caktuar; dhe për punë dhe detyra specifike.* Si rrjedhojë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar të drejtën materiale, pasi ka konstatuar se pretendimet e ngritura nga pala paditëse janë në kundërshtim me provat e bashkangjitura, siç është kontrata e fundit e punës nr.12265/8835, e nënshkruar nga paditësi me datë 01.04.2016, ku në nenin 1 të saj parashihet kohëzgjatja e kontratës dhe atë nga data 08.05.2016, e deri me datën 07.05.2017 *(ndërsa marrëdhënien e punës me të paditurën e ka themeluar në vitin 2014).* Në anën tjetër, nuk rezulton se paditësi e ka kundërshtuar një kontratë të tillë, për shkak të kohëzgjatjes së saj, qoftë para apo pas nënshkrimit të saj, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me rastin e mos vazhdimit të kontratës së punës ka vepruar në tërësi në përputhje me nenin 67.1, pika 1.3 *(me të cilën dispozitë parashihet ndërprerja e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore),* lidhur me nenin 71 parag.2 të Ligjit të Punës, duke e informuar në afatin e caktuar paditësin për mos vazhdimin e kontratës së punës, si dhe duke i kompensuar të ardhurat personale deri në ditën e skadimit të kohëzgjatjes së kontratës së punës.

Andaj, nga të cekurat më lartë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materiale - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e

kërkesëpadi së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadi e paditësit në rastin konkret është e pathemeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e pasditësit në rastin konkret është e pabazuar.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 449, 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.971/20, datë 06.05.2021

Kryetari i kolegjit,

Lumni Sallauka